



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1078 Prot.,

Tiranë, më 14. 07. 2021

LËNDA: Përcillen komentet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me “*Draft – tabelën e aktiviteteve të planit të ri për personat LGBTI në Shqipëri për vitet 2021 - 2027.*”

**ZNJ. BRUNILDA DERVISHAJ
PËRGJEGJËSE NË SEKTORIN E POLITIKAVE DHE STRATEGJIVE NË
PËRFSHIRJEN SOCIALE DHE GJINORE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Adresa: Rruga e Kavajës, Nr. 1001**

TIRANË

E Nderuar Znj. Dervishaj,

Në lidhje me kërkesën tuaj, të parashtruar në email-in e datës 06.07.2021, për dërgimin e komenteve dhe sugjerimeve në lidhje me “*Draft – tabelën e aktiviteteve të Planit te ri për Personat LGBTI në Shqipëri për vitet 2021-2027*”, ju bëjmë me dije se:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është krijuar dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, (i ndryshuar)¹, dhe në kuadër të ushtrimit prej tij, me statusin e institucionit të pavarrur publik:

- ✓ të atributave që i jepen prej Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, (i ndryshuar), për të siguruar mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ përbushjes prej KMD-së të qëllimit të Ligjit Nr. 10 221/2010, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpala ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin;
- ✓ zbatimit të nenit 32, pika 1, germa “e”, të Ligjit Nr. 10 221 datë 04.02.2010, i cili parashikon se: “*Komisioneri ka kompetencë t'u bëjë rekomandime autoritetet e kompetente, sidomos duke propozuar miratimin e legjisacionit të ri, ose ndryshimin apo reformimin e legjisacionit ekzistues*”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi parashtron në lidhje me “*Draft – tabelën e aktiviteteve të planit te ri për personat LGBTI në Shqipëri për vitet 2021 - 2027*”, komentet si më poshtë vijon:

¹Ndryshuar me Ligjin Nr. 124/2020 (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 191 datë 03.11.2020).

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 27, Kodi Postar 1001, Tiranë, Tel: + 355 42 43 10 78, Fax: + 355 42 43 10 77, E - mail: info@kmd.al, Web: www.kmd.al

1. Në lidhje me “Qëllimin e politikës 1: Forcimi i kompetencave, aksesueshmërisë dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimit publik për personat LGBTI, duke përfshirë në nivelin lokal, për të qenë në përputhje me kërkesat e zbatueshme dhe standardet evropiane”:

- Në objektivin specifik 1.1: “*Garantimi i respektimit të të drejtave të njeriut LGBTI nga nepunësit civilë në nivelin kombëtar, rajonal dhe lokal*”, Komisioneri rekomandon të vendosen si institucione përgjegjëse të dy organet e barazisë, dhe si aktivitet të parashikohet realizimi i një cikli trajnimesh për nepunësit civilë mbi respektimin e të drejtave të komunitetit LGBTI.
- Në objektivin specifik 1.2: “*Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në shërbimet sociale për personat LGBTI, duke i sjellë ata më pranë komunitetit në të gjithë vendin*”, Komisioneri rekomandon të vendosen si institucione përgjegjëse të dy organet e barazisë, duke kryer aktivitetin e raportimit mbi numrin e ankesave, çështjeve të shqyrtuara kryesisht, si dhe vendimeve dhe rekomandimeve të dhëna nga KMD lidhur me aksesin e personave LGBTI në shërbimet sociale.
- Në objektivin specifik 1.3: “*Garantimi i aksesit për personave LGBTI në nevojë për strehim dhe strehim social dhe shërbime për të luftuar dhunën në familje, duke përfshirë njësitet e mbrojtjes së fëmijëve*”, Komisioneri rekomandon të shtohet si aktivitet raportimi mbi çështjet e shqyrtuara, vendimet apo rekomandimet e dhëna nga KMD që lidhen pikërisht me këtë objektiv.
- Në objektivin specifik 1.4: “*Garantimi i aksesit të personave LGBTI në arsim, në të gjithë vendin*”, Komisioneri rekomandon përfshirjen si aktivitet raportimin e KMD-së mbi ankesat e shqyrtuara dhe vendimet/rekomandimet e dhëna në fushën e arsimit, për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit.
- Në objektivin specifik 1.5: “*Garantimi i aksesit për personat LGBTI në kujdesin shëndetësor, në të gjithë vendin*”, Komisioneri rekomandon të përfshihet si institucion përgjegjës, duke shtuar si aktivitet raportimin për çështjet e shqyrtuara, vendimet/rekomandimet e dhëna për periudha të caktuara, në fushën e shërbimeve (shëndetësi), për shkaqe si orientimi seksual, identiteti gjinor apo karakteristikat e seksit.
- Në objektivin specifik 1.6: “*Garantimi i aksesit të personave LGBTI në shërbimet e punësimit, në të gjithë vendin*”, Komisioneri rekomandon të shtohet si aktivitet raportimi për çështjet e shqyrtuara, vendimet dhe rekomandimet e dhëna, në fushën e punësimit, për shkaqet e cituara më sipër, ku KMD të jetë institucion përgjegjës.

2. Në lidhje me “Qëllimin e politikës 2: Përmirësimi, përditësimi dhe përafrimi i legjisacionit në lidhje me personat LGBTI me standardet evropiane dhe zbatimi i tij siç duhet”:

- Në objektivin specifik 2.5: “*Zbatimi si duhet i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI*”, Komisioneri rekomandon të shtohet si aktivitet raportimi mbi numrin e çështjeve të shqyrtaura dhe vendimeve/rekomandimeve të dhëna, ku është konstatuar përdorimi i gjuhës së urrejtjes ndaj komunitetit LGBTI, dhe të shtohet si institucion përgjegjës KMD për pjesën e raportimit. Ndërkohe për arritjen me efektivitet të këtij objektivi duhet të vendoset si institucion përgjegjës edhe Prokuroria e Përgjithshme, pasi luan një rol kyç në klasifikimin e krimeve të urrejtjes, dhe në mbajtjen e të dhënave respektive për këto raste. Për më tepër që raportimi i krimeve që lidhen me gjuhën e urrejtjes është i ulët, ndaj rekomandohet që të ketë në këtë drejtim një gjithëpërfshirje të organeve përgjegjëse.
- Në objektivin specifik 2.5: “*Zbatimi si duhet i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI*. Rezultati 2.5.1: Hartimi çdo vit i një raporti të konsoliduar për të gjitha rastet e raportuara të diskriminimit dhe krimit të urrejtjes kundër personave LGBTI, sipas një përkufizimi të përbashkët në përputhje me standarde ndërkombëtare siç është Këshilli i Evropës. Aktiviteti: Hartimi i një raporti vjetor për të gjitha rastet e raportuara të diskriminimit dhe krimit të urrejtjes ndaj personave LGBTI, sipas përkufizimeve të zakonshme, nën kujdesin e KMD, i cili paraqitet në Këshillin e Evropës. Prodhimi i raporteve vjetore të përpiluara nga KMD nga viti 2022 e tutje”, do të theksonim faktin që në referim të nenit 26 të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri çdo vit del me një raport vjetor ku përfshihet një analizë e gjithë veprimit tarisë së tij vjetore, ku një hapësirë zë edhe raportimi mbi rastet që lidhen me “gjuhën e urrejtjes”, si formë diskriminimi, kryesisht e përhapur ndaj komunitetit LGBTI. Megjithatë një raportim më i detajuar në këtë aspekt vlerësohet i drejtë nga ana jonë. Kjo në përmbushje edhe të një prej kompetencave që Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i cilia parashikon se Komisioneri ka kompetencë “*të publikojë raporte dhe të bëjë rekomandime përfarëdo lloj çështjeje që lidhet me diskriminimin*”. Gjithashtu mund të shihet si mundësi edhe përdorimi për analogji i botimeve vjetore të KMD-së, në formë të shkurtuar. Pra të botohen në mënyrë periodike, vendime të shkurtuara të rasteve të diskriminimit të komunitetit LGBTI për shkak të gjuhës së urrejtjes. Kopje të këtyre botimeve mund t'i dërgohen AMA-s dhe Këshillit Shqiptar të Medias. Propozojmë të shtohet si institucion përgjegjës Prokuroria e Përgjithshme, duke genë se bashkë me Policinë e Shtetit luan një rol kyç në klasifikimin e krimeve që lidhen me gjuhën e urrejtjes, dhe mund të raportojë të dhëna lidhur me këto raste.
- Në objektivin specifik 2.5: “*Zbatimi si duhet i legjislacionit për të luftuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes ndaj personave LGBTI*. Rezultati 2.5.2: Çështjet dhe protokollet LGBTI përfshihen si pjesë e detyrueshme e trajnimit në Akademinë e Sigurisë dhe në Shkollën e Magjistraturës. LGBTI përfshihen si pjesë e detyrueshme e trajnimit në Akademinë e Sigurisë dhe në Shkollën e Magjistraturës”, KMD do të rekomandonte realizimin e një sondazhi lidhur mbi

diskriminimin e personave LGBTI me qëllim që të evidentohen rastet e reportuara dhe të paraportuara, si dhe vendosjen e KMD-së si institucion përgjegjës, për pjesën e trajnimeve në Akademinë e Sigurisë dhe në Shkollën e Magjistraturës.

- Në objektivin specifik 2.5, Rezultati 2.5.5: “*Krijimi i mundësive për të raportuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor në nivelin rajonal, në bashkëpunim me KMD, Ombudsmanin dhe OJQ-të. Treguesi: X punonjës në nivel rajonal të trajnuar për të marrë siç duhet rastet e raportuara të diskriminimit dhe krimet e urrejtjes*”, duke qenë se Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi eshtë tashmë një institucion i konsiliduar në pritjen e ankesave që lidhen me diskriminim për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, rekomandojmë që të përcaktohet si aktivitet realizimi i trajnimeve të punonjësve në nivel rajonal, ku për një efektivitet më të madh të rezultateve, institacione përgjegjëse të parashikohen të dyja organet e barazisë.
- Në objektivin specifik 2.5, Rezultati 2.5.8: “*Ngritura e një mekanizmi referimi me pjesëmarrjen e policisë, prokurorisë, drejtësisë, KMD-së, ombudsmanit dhe OJQ-ve për të diskutuar rastet në vazhdim të diskriminimit dhe krimit të urrejtjes. Aktiviteti: Ngritura e një mekanizmi referimi me pjesëmarrjen e policisë, prokurorisë, drejtësisë, KMD-së, ombudsmanit dhe OJQ-ve për të diskutuar rastet në vazhdim të diskriminimit dhe krimit të urrejtjes*”, KMD thekson se një aktivitet i tillë, eshtë kryer në vazhdimësi nga ana jonë, kryesisht me organizatat joqeveritare. Ndaj, një përfshirje në të edhe e organeve të policisë, prokurorisë, drejtësisë dhe Avokatit të Popullit, vlerësohet maksimalisht nga ana jonë. Gjithashtu mund të mbahet parasysh edhe fakti që të realizohen takime periodike ndërmjet këtyre aktorëve ku të trajtohen raste konkrete.
- Në objektivin specifik 2.5, Rezultati 2.5.9: “*Ndërgjegjësimi i personave LGBTI në të gjithë vendin për mundësitë për të raportuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes, ndër të tjera në lidhje me raportimin anonim dhe qasjen në ndihmë juridike falas. Aktiviteti: Ndërgjegjësimi eshtë rritur midis personave LGBTI në të gjithë vendin për mundësitë për të raportuar diskriminimin dhe krimin e urrejtjes, ndër të tjera në lidhje me raportimin (anonim), informacionin e kontaktit për pikat fokale të policisë dhe mënyrën e përdorimit të ndihmës ligjore falas*”, do të theksonim faktin që një hap pozitiv që eshtë ndërmarrë që prej fundit të vitit 2020 në këtë drejtim, eshtë edhe ndryshimi i Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, konkretisht neni 33 i tij. Më përpëra parashikohej që ankesa e depozituar pranë KMD-së nuk pranohej nëse eshtë anonte. Me Ligjin Nr. 124/2020, kjo pikë e nenit u shfuqizua, pikërisht me qëllimin që personave nga komuniteti LGBTI, t'i jepet mundësia që të paradesin ankesa edhe anonte. Përsa kohë që edhe një ndër kompetencat që Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i ka dhënë Komisionerit eshtë edhe “të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësimi dhe edukimi që ndihmojnë në zbatimin e këtij ligji”, mund të konsiderohet që KMD të përfshihet si institucion

bashkëpunues në këtë drejtim. Gjithashtu do të rekomandonim që të shtohej si aktivitet realizimi i fushatave ndërgjegjësuese kryesisht në zonat rurale.

3. Në lidhje me “*Qëllimin e politikës 3: Ndërgjegjësimi i publikut mbi të drejtat e njeriut LGBTI dhe pranimi i personave LGBTI mes publikut të gjerë, duke përfshirë, por pa u kufizuar tek qytetarët, OJQ-të, sektori privat dhe grupet profesionale*”:

- Në objektivin specifik 3.1: “*Përmirësimi i ndërgjegjësimit të publikut për çështjet LGBTI dhe qëndrimi i publikut të gjerë ndaj personave LGBTI*”, KMD rekomandon që institucione përgjegjëse për pjesën e sondazhit të jenë të dyja organet e barazisë, në mënyrë që edhe niveli i përfshirjes së publikut të jetë sa më i gjerë.
- Në objektivin specifik 3.1: “*Përmirësimi i ndërgjegjësimit të publikut për çështjet LGBTI dhe qëndrimi i publikut të gjerë ndaj personave LGBTI. Rezultati 3.1.1: Kryerja e një fushate në vazhdim të ndërgjegjësimit publik të mbështetur dukshëm nga qeveria*”, do ishte e përshtatshme të mbahej parasysh shtrirja e kësaj fushate në çdo qytet.
- Në objektivin specifik 3.2: “*Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI dhe qëndrimet ndaj personave LGBTI midis punëdhënësve*”, KMD rekomandon që të mbahet në fokus, bashkëpunimi ndërinstitucional lidhur me kryerjen e aktiviteteve ndërgjegjësuese për këtë objektiv.
- Në objektivin specifik 3.2: “*Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI dhe qëndrimet ndaj personave LGBTI midis punëdhënësve. Rezultati 3.2.1: Punëdhënësit marrin masa për të parandaluar diskriminimin ndaj personave LGBTI në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe brenda ndërmarrjes*”, KMD rekomandon se duhet të përfshihet si institucion përgjegjës.
- Në objektivin specifik 3.3: “*Përmirësimi i ndërgjegjësimit për çështjet LGBTI dhe qëndrimet ndaj personave LGBTI mes të rinjve*”, KMD rekomandon se duhet që të shtohen si institucione përgjegjëse të dyja organet e barazisë.

4. Në lidhje me “*Qëllimin e politikës 4: Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe partneritetet për zhvillim të qëndrueshëm*”:

- Në objektivin specifik 4.2: “*Monitorimi efektiv i progresit drejt qëllimeve të PKV. Rezultati 4.2.5: Shqipëria merr pjesë aktive në shkëmbimet përkatëse të mbledhjes së të dhënavë dhe iniciativat e Bashkimit Evropian. Aktiviteti: Qeveria dhe institucionet përkatëse marrin pjesë, ndër të tjera, në: Nëngrupi i të dhënavë të barazisë së Grupit të Nivelit të Lartë mbi mosdiskriminimin, barazinë dhe diversitetin; Sigurimi i asistencës teknike dhe mbështetjes metodologjike të FRA dhe EIGE; Tabela e rrumbullakët e planifikuar e BE-së mbi të dhënat e barazisë; Takime teknike midis EUROSTAT dhe zyrave kombëtare të statistikave; Një*

*sondazh gjithëpërfshtirës LGBTIQ që do të kryhet nga FRA në 2024". Në mënyrë që të gjitha aktivitetet e listuara të kryhen në mënyrë efektive, duhet një nivel i lartë **bashkëpunimi** mes aktorëve kryesorë, ndaj e shohim të arsyeshme referuar edhe Raportit të ECRI-t të miratuar në 7 prill 2020², që të shtohen si institucione përgjegjëse të dyja organet e barazisë. Gjithashtu duke qenë se KMD është përcaktuar si institucion përgjegjës, do rekomandonim të specifikohej se çfarë roli konkretisht do ketë KMD në këto aktivitete të listuara.*

*Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,
Me konsideratë,*



² Raporti i ECRI-t, miratuar në 07.04.2020, botuar në 02.06.2020, në Kapitullin II, pika A, paragrafi 26 dhe 29, faqe 15 - 16, "... rekomandon që autoritetet të krijojnë një sistem gjithëpërfshtirës të monitorimit për incidente të gjuhës së urrejtjes. Në këtë drejtim, ata duhet të bazohen në përvojat dhe ekspertizën, si dhe të punojnë ngushtë me Avokatin e Popullit, Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, prokurorinë, policinë dhe organizatat përkatëse të shoqërisë civile, kryesisht ato të komuniteteve që preken në veçanti nga gjuha e urrejtjes siç janë romët, egjiptianët dhe personat LGBTI ... ECRI rekomandon që autoritetet të vazhdojnë të organizojnë takime konsultimi midis oficerëve të polisë, përfaqësuesve të grupeve të cenueshme dhe OJQ-ve në mënyrë që të krijojnë dialog të rregullt, besim të ndërsjellë dhe bashkëpunim. ".